



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 40
Prishtinë, më 04 shkurt 2010
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203
Mbledhja filloi në orën 16:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë anëtarët e Komisionit: Rustem Mustafa, Suzana Novoberdaliu , Shkumbin Demaliaj, Melihate Termkolli dhe Lulzim Zeneli.

Munguan:Eqrem Kryeziu, Zafir Berisha, Zylfi Merxha dhe Bojan Stojanović.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi, Blerina Pula dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i situatës së sigurisë në Kosovë, pas grevës së Policisë së Kosovës

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i situatës së sigurisë në Kosovë, pas grevës së Policisë së Kosovës

Kryetari i Komisionit – tha, sot kemi thirrur mbledhje të jashtëzakonshme me një pikë të rendit të ditës, për të shqyrtuar situatën e krijuar në Policinë e Kosovës. Në këtë mbledhje janë thirrur përfaqësuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës. Nga këto institucione nuk kanë ardhur përfaqësuesit të ftuar në këtë mbledhje. Kjo tregon që nuk është duke ndodhur komunikimi i mirë në mes të institucioneve. Situata aktuale e sigurisë nuk është e mire, dhe në çdo moment pres që në këtë mbledhje të vijnë përfaqësuesit nga MPB-ja dhe Policia e Kosovës me ndonjë informatë për ngjarjet e fundit. Kjo situatë po ndodh për shkak të mos komunikimit në mënyrë të duhur të institucioneve.

Suzana Novoberdaliu - Unë mendoj që kjo situatë nuk është e befasishme për ne. Këtë shprehje të pakënaqësisë nga ana e policëve, ne e kemi pa edhe më herët, dhe këto që po ndodhin sot ne i kemi pritur. Edhe unë sot këtu po shprehi pakënaqësinë po mospjesëmarrjen e MPB-së dhe Policisë së Kosovës, të cilët është dashur të vijnë të raportojnë se çka ka ndodhur dhe çka është ndërmarr me këtë rast.

Shkumbin Demaliaj – Nuk ka të drejtë askush t’iu premtoj as një shërbyesi civil e as policëve, diçka që nuk mund të realizohet me kohë. Policia brenda për brenda ka një organizim sindikal, i cili jashtëligjshëm ka komunikuar me kryeministrin e Kosovës. Premtime të pamatura prej kryeministrisë nuk duhet të bëhen. Po edhe mos ardhja e përfaqësuesve të MPB-së dhe Policisë është bojkotim nga institucionet bazike. Është e pajustificueshme mosardhja e vartësve të institucioneve, edhe pse nuk është hera e parë që ndodh kjo.

Lulzim Zeneli – Unë mendoj se po bëhet gati një vit e gjysmë që në Kosovë po rrezikohen shtyllat kryesore të shtetësisë, në ato shtylla që është investuar aq shumë. Kjo që ka ndodhur me Policinë e Kosovës është akumulim i pakënaqësive për një kohë të gjatë. Unë pashë dje një deklaratë ku përgjegjësia ju adresua Kuvendit të Kosovës, kur rregullon buxhetin dhe përcakton politikën, që është diçka e pakuptimtë. Është shumë keq që ne sot nuk e kemi ndonjë informatë se çka është duke ndërmarr Qeveria aktualisht, a ka pasur negociata me dikë, apo çka mund të bëjë Kuvendi për këtë.

Melihate Termkollli – Ju përgëzoj për këtë takim, është në nivel të përgjegjësive që i kemi si Parlament i Kosovës dhe në veçanti si komision. Edhe po të mos kishte iniciativë ky komision, Qeveria do të duhej të kërkonte nga komisioni parlamentar ta ndihmojë, të kërkojë zgjidhje në mënyrë që të dilet nga kjo situatë. Ne duhet ta trajtojmë çështjen me seriozitetin më të madh. Ne mund të flasim dhe japim idetë por nuk kemi një informacion të bollshëm prej institucioneve zyrtare por veç prej mediave. Ne si komision e kemi bërë një amendament ku i kërkohet Qeverisë që të rris buxhetin për pagat e policëve. Qeveria për këtë rast nuk ka ndërmarr asnjë hap. Komisioni duhet të kërkojë nga Qeveria që të gjejë zgjidhje për kërkesat e policëve.

Kryetari i Komisionit – tha, desha të tregoj se ftesa nuk është bërë vetëm për individin por edhe përfaqësuesit e tij, kjo e rëndon edhe më shumë përgjegjësinë e këtyre institucioneve, sepse kemi kërkuar informatë zyrtare. Ju lus që të qëndroni afër në ditët e ardhshme, nëse marrim ndonjë vendim për të shkuar në ndonjë takim, në lidhje me situatën e krijuar.

Lulzim Zeneli – Sa i përket nenit 59.3, thuhet se zyrtarë të policisë nuk kanë të drejtë të bëjnë greva, por kanë të drejtë të bëjnë protesta. Nëse kjo pakënaqësi shprehet duke hyrë në grevë nga një grup i organizuar, ndërsa në anën tjetër policët tjerë i kryejnë detyrat e veta atëherë unë mendoj se gjithçka është në rregull. Sa i përket pjesës parë, nuk mund të paralizohet ky sektorë, kjo shtyllë.

Kryetari i Komisionit – Duhet te kërkohet Kryeministria informatë për situatën e krijuar, ndërsa nga Policia, kërkohet që ta respektojë ligjin.

Pasi që nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa